



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori i Emergjencave Civile

Nr. 187/24 Prot.

Puke, me 14.11.2024

P/V E N D I M

Nr. 3, Date 14.11.2024

Per rishqyrtimin e pikes 1 dhe 8 te Vkb nr. 47 date 16.10.2024 Per miratimin e kerkeses se Bashkise Puke, per akordimin e ndihmes se menjehershme financiare, se bashku me dokumentacionin tekniko ligjorë per familjen e Z. Ardian Keci, banesa e te cilit eshte demtuar nga renie zjarri (djegie), nga fondi i kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile dhe fondi emergjenca civile, buxheti i Bashkise Puke

Ne mbeshtetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". neni 29, neni 54 shkronja "dh", neni 55 pika 3, neni 64 shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", të VKM Nr. 329 date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore" kreu III Vkm nr 414 date date 08.07.2021 " Per miratimin e procedurave te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile" Shkreses nr. 446/2 Prot date 20.02.2024 " Mbi fondin e Kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile, të Vendimi i Keshillit Bashkiak Puke nr. 47 date 29.12. 2023 "Per miratimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetin e vitit 2024", shkreses nr. 730/1 Prot date 01.11 2024 " Mbi Vendimin nr 47 date 15.10.2024 te Keshillit Bashkiak Puke" me propozim te Kryetarit te Bashkise ,Keshilli i Bashkise Puke, pasi mori ne rishqyrtim dokumentacionin tekniko ligjor, diskutoi dhe ne perfundim me _____ vota:

V E N D O S I:

1. Te miratoje kerkesen e Bashkise Puke per dhenien e ndihmes se menjehershme financiare per familjen e shtetasit Ardian Keci , per demtimin e baneses se tij nga renie zjarri Djegie ne masen 120000 leke .
2. Ti akordoje familjes se shtetasit Ardian Keci ndihmen e financiare ne vleren totale: 1018120 leke.
3. Te miratoje vleren ne masen 800.000 leke nga Fondi i kushtezuar i buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile me kod produkti - 91707AB- "Shtetas ve ndihmuar banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme".

4. Te miratoje vlere ne masen 218120 leke nga buxheti per emergjenca civile I Bashkise Puke i vitit 2024 ,duke pakesuar fonfin rezerve ne vkb nr 47 date 29.12.2023,kapitull 01, Program 04910, llogari ekonomike 60900000fondi emergjencave.
5. Ndhurma financiare per familjen e shtetasit Ardian Keci , percaktohet sipas VKM nr. 329, date 16.05.2012.
6. Vlera e plotë e dëmit sipas vlerësimit te grupit të punës së Bashkisë Pukë është:1.805.257.08lekë
7. Vlera e plote e demit nga ana ndertimore eshte: 1.106.777.08 lekë dhe 50% e vleres ne masen 553.388.5 leke akordohet per ndihme financiare.
8. Vlera e plote e demit ne paisje dhe oriendi eshte ne masen 698.480 leke dhe 50 % e vleres ne masen 344740 leke akordohet per ndihme finaciare.
9. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finaces, Sektori i Emergjencave Civile
10. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “ Per vetqeverisjen vendore”

Drejtoria e Finances

P/ Sektorit Emergjencave

K R Y E T A R I

Fiqirete LATIFI

Behar ADEMI

Rrok DODAJ



JURISTI

Aida SINANI



D. nr. 1877/5 prot.

Relacion

Keshillit te Bashkise Puke

Per dhenie ndihme financiare per rast fatkeqesie

Z. Ardian Keci , Fshati Mesul Njesia Administrative Gjegjan Bashkia Puke

Renie zjarri (Djegje) objektin shtepi banimi sipas kerkeses se z. Ardian Keci date 21.09.2024:

Objekti : Mbi konstatimin ne vend te demeve te shkaktuara nga djegia e shtepise se banimit e z. Ardian Keci me date 21.09.2024 fshati Mesul ,Njesia Administrative Gjegjan , Bashkia Puke

Te pranishem ne momentin e verifikimit : Komisioni i Bashkise Puke, dhe K\familjari bashke me bashkeshorten e femijet e tyre.

Nga konstatimi ne vend komisioni vlersoi : keto deme:

- Deme nga ana ndertimore grupi i punes konstatoi se nga renia e zjarrit ne shtepine e shtetasit Adian Keci ka demtime objektit si me poshte:
- Eshte demtuar objekti shtepi banimi: 1 kateshe, muri , tavani catia , dyer, dritare etj te shprehura ne preventivin e vlersimit nga ana ndertimore e hartuar nga grupi i punes.
- Deme ne paisje dhe oriendi Jane djegur plotesisht te gjitha paisjet dhe oriendite shtepiake qe ndodheshin ne banese te shprehura ne preventivin e hartuar paisje dhe oriendi te djegura ne banesen e famijes se z. Ardian Keci
- Demet e shkaktuaranga zjarri kane bere qe familja e z. Ardian Keci e perbera nga 4 anetare bashkeshortja dhe dy femijet te jene aktualisht ne kushte tejet te veshtira jetese.
- Grupi i punes sipas verifikimit ne vend ka hartuar dhe preventivat perkates sipas zerave te objektit demtuar nga ana ndertimore dhe paisje dhe oriendi shtepiake
- Vlera e demeve te shkaktuara nga ana ndertimore sipas preventivit te hartur eshte ne masen 1.106.777.08 leke
- Vlera e demit te shkaktuar ne paisje dhe oriendi shtepiake sipas preventivit te hartuar eshte ne masen 698480 leke
- Vlera totale e demeve te shkaktuara eshte ne masen 1.805.257.08leke

Sa me siper Grupi i punes i propozon Keshillit te Bashkis Puke, qe ne baze te kompetencave ligjore, te miratoje akordimin e ndihmes financiare per perballimin e situates se krijuar per familjen e z. Ardian Keci.

Shumen totale: 1018120 leke.

Dhenie ndihme te menjershme financiare per familjen e z. Adjan Keci e cila perbehat nga 4 anetare me nga 30000 leke sipas cerifikates familjare: $4 \times 30000 = 120000$ leke

Per demet e shkaktuara sipas preventivit nga ana ndertimore Shumen 553.388.5 leke/ 50% e vleres totale te prentivit sipas pikes 3 shkronja ç e Vkm nr. 329/2012.

Per demet e shkatuara ne paisje dhe oriendi shtepiake Shumen 3344740 leke 50% e vleres totale te preventivit sipas pikes 3 shkronja d te Vkm nr. 329//2012.

Ndihma financiare per demet e shkatuara nga djegia shtepise se shtetasit Ardian Keci do te jepet nga Fondi i kushtezuar i buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile me kod produkti 91707 AB ne masen 800.000 leke dhe nga buxheti per emergjenca civile i bashkise Puke duke pakesuar fondin rezerve ne vkb nr. 47 date 29.12.2023 kapitull 01, prograra 04910, fondi i emergjencave ne masen 218120 leke.

Pergjegjes i Sektorit te Emergjencave

Behar Ademi





09.11.24

2024/11/09/11/24
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 730/I prot.

Shkodër, më 09.11.2024

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 47, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe anëksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, pika 1, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 1896/3 prot., datë 22.10.2024 "Dërgojmë Vendimet e Këshillit Bashkiak Pukë të datës 16.10.2024", të datës 02.07.2024", shqyrtoi VKB Pukë nr. 47, datë 16.10.2024 "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë, për akordimin e ndihmës së menjehershme financiare, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për familjen e z. Ardian Keci, Fshati Mesul, NJAD Gjegjan, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënie zjarri sipas "Vërtetim për rënie zjarri" të MZSH të datës 27.09.2024, nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe nga fondi i emergjencave civile nga buxheti i Bashkisë Pukë", me vlere totale të dëmeve ndërtimore dhe në orendi 1 988 063,5 lekë.

Gjatë trajtimit, konstatohet se nuk është zbatuar shkronja "ç" e pikës 3, Kreu III e VKM Nr.329/2012, e cila shprehet se masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale (banesa dhe orendi) do të jetë 50% e vlerës së llogaritur, ndërkohë sipas pikës 8 të vendimit Tuaj është akorduar vlere e dëmit në orendi dhe paisje në masën 100%.

Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedim të mëtejshëm, por keni detyrimin e korigjimit të vendimarrjes në mbledhjen më të afët të këshillit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Matilda ANGONI